



Universiteti "Fan S. Noli"
FAKULTETI I EKONOMISË

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI"
FAKULTETI I EKONOMISË
KORÇË**

Adresa: Shëtitore "Rilindasit"

Tel/Fax: ++355 82 242201

Web: www.unkorce.edu.al

2016 - 2020

**FAKULTETI I EKONOMISË
PLANI I ZHVILLIMIT**



TABELA E PËRMBAJTJES

Parathënie→3

Kontekst→4

Pozicionimi strategjik aktual→5

Plani i zhvillimit 2016 - 2020→8

Parathënie

Në shoqëritë e sotme të dijës, Universitetet janë jetike për zhvillimin social, ekonomik dhe kulturor të një vendi. Fakulteti i Ekonomisë është pjesë përbërëse e Universitetit "Fan S. Noli". Mësimdhënia dhe kërkimi shkencor në Fakultetin e Ekonomisë përfshin fushat e financës dhe kontabilitetit, manaxhimit, administrimit të biznesit, marketingut dhe turizmit.

Ky Plan Zhvillimi vendos parimet udhëheqëse për zhvillimin e mëtejshëm të Fakultetit të Ekonomisë dhe liston masat kryesore që duhet të ndërmerren. Ai formon një bazë të rëndësishme për punën e vendimmarrësit të Fakultetit të Ekonomisë dhe Universitetit.

Për sa i përket kërkimit, Plani i Zhvillimit përcakton një profil dinamik evolues që e ve theksin tek kërkimi i hapur për aplikim, si dhe kërkimi ndërdisiplinor. Duke ndjekur parimin e kombinimit të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, këto karakteristika duhet të jenë të përkthyer kryesisht në programet master. Kuadri i Bolonjës do të përdoret për të siguruar një lëvizje më të madhe vertikale dhe horizontale.

Fakulteti është i angazhuar në të gjitha fushat për rritjen e cilësisë. Konkurrenca luan një rol të madh në këtë drejtim. Megjithatë, Fakulteti gjithashtu ka për qëllim që të arrijë dhe ruajë ekuilibrin e duhur midis konkurrencës dhe bashkëpunimit, si në kuadër të Universitetit ashtu dhe në marrëdhëniet e tij me institucionet e tjera arsimore dhe kërkimore.

Suksesi i Fakultetit është ndërtuar mbi bazën e përkushtimit të të gjithë anëtarëve të tij. Në këtë kontekst Fakulteti ndjek një politikë të mundësive të barabarta dhe është kundër çdo forme të diskriminimit direkt apo indirekt.

Për të arritur këto objektiva është e nevojshme që të fillojë të zbatohet dhe të ruhet autonomia e garantuar me ligj në mënyrë që të rritet bashkëpunimi ndërmjet organeve të ndryshme të qeverisjes (qëndrore dhe veçanërisht asaj lokale) dhe niveleve organizative të Fakultetit. Përveç kësaj, të gjithë anëtarët e Fakultetit duhet të integrohen në mënyrën e duhur në procesin e vendimmarrjes duke përdorur njohuritë e tyre si ekspertë.

Mbi të gjitha, për të arritur objektivat e tij, Fakulteti ka nevojë për fonde të mjaftueshme dhe të qëndrueshme që të mbulojë kostot e plota për studime të të gjithë studentëve si dhe aktivitetet kërkimore të tij.

DE K A N I
Prof.Asc.Dr. Frederik ÇUÇLLARI

Kontekst

Fakulteti i Ekonomisë filloi aktivitetin e tij si pjesë përbërëse e Universitetit "Fan S. Noli" në vitin 1992. Kalimi i ekonomisë shqiptare në një ekonomi tregu e bënë të domosdoshëm krijimin e një Fakulteti të tillë, i cili do të ofronte njohuritë teorike dhe shprehitë praktike të nevojshme për të kuptuar dhe përditësuar funksionimin e ekonomisë.

Hapat kryesorë të Fakultetit të Ekonomisë

1992	Hapja e Fakultetit të Ekonomisë
29.05.1992	Licensimi i Programeve të Studimit 4 vjeçare, me kohë të plotë, <i>Menaxhim; Marketing; Turizëm; Vendim Nr.230</i>
Vera e vitit 1996	Diplomimet e para në Programet e Studimit 4 veçare
04.08.1998	Licensimi i Programit të Studimit 4 vjeçar, me kohë të plotë, <i>Financë-Kontabilitet; Vendim Nr.142</i>
23.10.2003	Licensimi i Programeve të Studimit 4 vjeçare, me kohë të pjesshme, <i>Financë-Kontabilitet; Menaxhim; Marketing; Turizëm; Udhëzim Nr.20</i>
18.06.2009	Licensimi i Programit të Studimit Bachelor, me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme, <i>Turizëm (Filiali Pogradec); Vendim Nr.675</i>
23.11.2010	Licensimi i Programeve të Studimit Master Profesional, <i>Financë-Kontabilitet; Administrim Biznesi; Marketing; Turizëm; Vendim Nr.565</i>
18.02.2011	Licensimi i Programit të Studimit <i>Master i Shkencave në Administrim Biznesi në Turizëm dhe Mikpritje; Vendim Nr.145</i>
20.11.2012	Licensimi i Programit të studimit <i>Master i Shkencave në Financë; Vendim Nr.575</i>
Pranvera e vitit 2013	Diplomimet e para në Programet e Studimit Master
03.06.2013	Licensimi i Programeve të Studimit Bachelor, me kohë të plotë, <i>Administrim Biznesi në Marketing; Administrim Biznesi në Turizëm; Vendim Nr.499</i>

Sot Fakulteti i Ekonomisë ofron diploma:

- në katër Programe Studimi Bachelor:
 - ✓ *Financë-Kontabilitet;*
 - ✓ *Menaxhim;*
 - ✓ *Administrim Biznesi në Marketing;*
 - ✓ *Administrim Biznesi në Turizëm;*

- në katër Programe Studimi Master Profesional:
 - ✓ *Financë-Kontabilitet;*
 - ✓ *Administrim Biznesi*
 - ✓ *Marketing;*
 - ✓ *Turizëm;*

- në dy Programe Studimi Master i Shkencave:
 - ✓ *Financë*
 - ✓ *Administrim biznesi në turizëm dhe mikpritje*

Në secilin Program Studimi jepen njohuri bazë dhe bashkëkohore lidhur me funksionimin e ekonomisë së tregut. Zgjerimi i arsimit universitar, rritja e kërkesës së tregut për profesionin e ekonomistit dhe liria e studentëve për të studiuar në Programet e Studimit që dëshirojnë, kanë bërë që të kemi prurje relativisht të larta të studentëve në të gjitha Programet e Studimit që ofrohen nga Fakulteti i Ekonomisë.

Pozicionimi strategjik aktual

Analiza e mëposhtme SWOT është rezultat i diskutimeve të plota midis stafit akademik të çdo departamenti (duke përfshirë edhe studentët përmes anketimeve dhe intervistave), si dhe është pasqyruar dhe ripunuar në të gjitha raportet e vetëvlerësimit (vlerësimit të brendshëm), dhe të vlerësimit të jashtëm, duke përfshirë edhe reflektimet dhe mësimet e nxjerra përmes proceseve të akreditimit të kaluara deri tani nga Fakulteti i Ekonomisë.

Fuqitë

1. Tradita dhe përvoja e Fakultetit të Ekonomisë, për një periudhë 24 vjeçare
2. Programe akademike bashkëkohore. Kurrikula të veçanta në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit.
3. Shkalla e lartë e kualifikimit të vazhdueshëm të stafit akademik të brendshëm të Fakultetit dhe atij mbështetës.
4. Përdorimi me efektivitet i pajisjeve audiovizive për zhvillimin e mësimin dhe të veprimtarive të tjera, si dhe aksesin në internet.
5. Zhvillimi i programeve Master Profesional dhe Master i Shkencave.
6. Lidhjet e ngushta të Fakultetit tonë me fakultetet homologe brenda dhe jashtë vendit.
7. Pjesëmarrja e gjerë e stafit të Fakultetit në konferenca kombëtare e ndërkombëtare.
8. Bashkëpunimi i ngushtë i anëtarëve të Fakultetit në botime artikujsh shkencore në nivel kombëtar e ndërkombëtar.
9. Preferencë e lartë nga maturantët për programet e studimit të ofruara nga Fakulteti i Ekonomisë.
10. Marrëdhënie shumë të mira me studentët.

Dobësitë

1. Mungesa e autonomisë financiare.
2. Cilësia relativisht e dobët e studentëve në hyrje për disa programe studimi.
3. Përdorimi joeficient i burimeve të bibliotekës.
4. Mungesa e mundësive për të krijuar lidhje të mira të teorisë me praktikën.

Mundësitë

1. Miratimi i programeve të reja të ciklit të dytë dhe mundësia e bashkëpunimeve për programe të ciklit të tretë të studimeve.
2. Shanse për rritjen e bashkëpunimit të Fakultetit me biznesin rajonal.
3. Kthimi i Fakultetit në një qendër trajnimi nga pikpamja e njohurive ekonomike në rajonin juglindor të vendit.
4. Pozita e favorshme gjeografike e rajonit për tërheqjen e studentëve edhe nga vendet kufitare për programe të ndryshme studimi.

Rreziqet

1. Vështirësi në rekrutimin e një stafi të kualifikuar
2. Vendimmarrje e centralizuar

PLANI I ZHVILLIMIT 2016-2020

Ky plan strategjik do të shërbejë si një strukturë ku do të mbështetemi, në mënyrë që Fakulteti i Ekonomisë të zhvillojë dhe të përdorë më me efektivitet burimet e tij. Plani fillimisht prezanton deklaratën e misionit, vizionin, vlerat themelore si dhe fushat apo linjat kryesore ku do të fokusohemi. Në këtë plan strategjik ne propozojmë rezultatet kryesore (të pritshme) si tregues të performancës, për çdo fushë. Treguesit e performancës janë të lidhur ngushtë me objektivat specifike të Planit të zhvillimit të Universitetit "Fan. S. Noli", Korçë, 2016-2020.

Misioni

Fakulteti i Ekonomisë iu ofron studentëve kushte për edukimin e tyre në përputhje me sfidat e Integritetit Europian për të formuar dhe përgatitur specialistët e ardhshëm që t'i përshtaten situatave konkurruese të tregut në zgjidhjen e problemeve ekonomike nëpërmjet zhvillimit dhe transmetimit të dijeve me anën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.

Fakulteti i Ekonomisë funksionon si pjesë përbërëse e Universitetit "Fan S. Noli" Korçë. Qëllimi afatgjatë i Fakultetit është përshtatja dhe përmirësimi i vazhdueshëm i programeve Bachelor dhe Master, me qëllim përgatitjen e profesionistëve të suksesshëm të biznesit, në kushtet e një zhvillimi dhe ndryshimi të shpejtë të gjithë shoqërisë. Fakulteti është i angazhuar të zhvillojë dhe të ruajë një reputacion të lartë akademik në shërbim të rekrutimit të studentëve sa më cilësorë.

Avantazh konkurrues i Fakultetit sot mund të konsiderohet kualifikimi i stafit dhe angazhimi serioz në mësimdhënie dhe kërkim shkencor, ndërkohë që duhet të shtojmë përpjekjet për rritjen e numrit të studentëve cilësorë si dhe rritjen e mbështetjes nga komuniteti i biznesit. Përbushja e misionit varet nga përpjekjet e përbashkëta të të gjithë pedagogëve të Fakultetit.

Përbushja e këtij misioni do të realizohet përmes këtyre objektivave:

- Të ofrojë njohuri bazë shkencore-teorike, bashkëkohore në fushën e ekonomisë.
- Të ofrojë njohuri praktike për t'iu përshtatur sa më mirë dhe sa më shpejt, detyrave konkrete në vendet e punës.
- Të rritë aftësitë teorike dhe praktike duke bërë profilizimin profesional.

- Të krijojë mundësi për kualifikimin e vazhdueshëm të specialistëve të rinj në fushën e ekonomisë.
- Të forcojë lidhjet dhe shkëmbimet me fakultetet e tjera homologe brenda dhe jashtë vendit.
- Të luajë një rol aktiv si pjesëmarrës në projekte kërkim-zhvillimi duke ju përgjigjur perspektivës së zhvillimit të Rajonit.

Vizioni

Vizioni i Fakultetit është të jemi zgjedhja e studentëve cilësorë të Rajonit Juglindor dhe më gjerë duke garantuar një mjedis atraktiv në të cilin çdo student mund të jetë i suksesshëm.

Ne besojmë se angazhimi i studentëve është shumë i rëndësishëm për suksesin e tyre. Në mbështetje të këtij angazhimi, do të ofrojmë për studentët staf të kualifikuar, kurrikula dhe programe cilësore, partneritet, programe akademike të aplikueshme dhe mbështetje të iniciativave të reja. Programi ynë akademik do të jetë konkurrues me programet më të mira të Fakulteteve homologe në vend. Fakulteti do të luajë një rol të rëndësishëm në përmbushjen e qëllimit të Universitetit, për të qënë një ndër Universitetet më të mira të vendit. Gjithashtu, do të mbështetet stafi akademik në kërkimet e tij dhe do të rriten përpjekjet për të garantuar njohjen kombëtare dhe ndërkombëtare të kërkimeve shkencore.

Vlerat themelore

1. Ne vlerësojmë *standardet e etikës*. Si fakultet ne vlerësojmë ndershmërinë, integritetin dhe dinjitetin në marrëdhëniet tona me kolegët, studentët dhe synojmë të veprojmë në përputhje me standardet më të larta të etikës profesionale.
2. Ne vlerësojmë *studentët*. Si fakultet ne kemi përgjegjësinë të mbështesim, të punojmë me studentët dhe të lehtësojmë procesin e të mësuarit, në një mjedis mësimor cilësor.
3. Ne vlerësojmë *procesin e mësimdhënies*. Si fakultet ne kemi përgjegjësi të zhvillojmë dhe ofrojmë programe mësimore me cilësi të lartë.
4. Ne vlerësojmë *procesin e kërkimit shkencor*. Si fakultet ne dëshirojmë të zgjerojmë njohuritë në disiplinat tona duke bërë hulumtime të vlefshme, si dhe ti ofrojmë këto njohuri nëpërmjet mësimi, kontributit intelektual dhe aktiviteteve të shërbimit.

5. Ne vlerësojmë komunitetet të cilave iu shërbejmë. Ne njohim dhe vlerësojmë kontributet që komunitetet ofrojnë për Fakultetin, në format e studentëve, burimeve, oportuniteteve për biznes dhe rritje personale. Ne, gjithashtu vlerësojmë mbështetjen e qeverisjes vendore për informacion dhe këshillim. Si Fakultet, ne kërkojmë të eksplorojmë mundësi të reja për shpërndarjen e njohurive në këto komunitete.

6. Ne vlerësojmë inovacionin dhe përmirësimin e vazhdueshëm në të gjitha drejtimit, veçanërisht në programet mësimore. Këto përpjekje janë në funksion të arritjes së qëllimit të Universitetit, në lidhje me këtë objektiv. Për këtë arsye, në mënyrë të vazhdueshme inkurajojmë stafin të përfshihet në aktivitete që mbështetin zhvillimin profesional.

7. Ne vlerësojmë diversitetin, gjithëpërfshirjen dhe bashkëpunimin. Ne respektojmë të drejtat, kulturën, dhe dinjitetin e të gjithë individëve, duke i konsideruar si anëtarë të një skuadre.

Fushat (drejtimit) kyesore

Objektivat e Fakultetit burojnë nga Misioni, Vizioni dhe Vlerat themelore të tij. Këto objektiva bazohen në analizën e plotë të fuqive, dobësive, mundësive dhe rreziqeve. Qëllimet e Fakultetit janë kategorizuar në këto fusha (drejtime) kryesore.

1. Programet Bachelor
2. Programet Master
3. Kontributet intelektual
4. Zhvillimi i fakultetit dhe i stafit
5. Ndërkombëtarizimi
6. Diversiteti, gjithëpërfshirja dhe ndërgjegjësimi multikulturor
7. Zhvillimi i bashkëpunimit (partneritetit) me biznesin

1. Programet bachelor

Qëllimi:

Fakulteti i Ekonomisë do të vazhdojë t'i kushtojë një vëmendje të veçantë programeve të ciklit të parë të studimeve Bachelor duke u përkushtuar për të garantuar mësimdhënie efektive, këshillim, rritje profesionale dhe mundësi zhvillimi për studentët e këtij niveli. Studentët do të marrin një edukim të plotë duke u plotësuar me njohuri të thella dhe të integruara në fushat përkatëse. Së fundi, ne synojmë t'iu sigurojmë studentëve njohuritë e nevojshme, për të konkurruar në pozicionet bazë profesionale dhe për të avancuar më tej në karrierë. Për më tepër

qëllimi i Fakultetit është të ofrojë programe studimi të barassvlefshme ose më të mira se Fakultetet homologe.

Prioritetet dhe iniciativat kryesore

1. Ristrukturimi i vazhdueshëm i kurrikulave, përmbajtjes dhe cilësisë së tyre për të ofruar njohuritë dhe aftësitë e nevojshme të kërkuara nga mjedisi i biznesit. Synojmë përdorimin e një shumëllojshmërie teknikash pedagogjike, lektorë të ftuar, mjete (kompjuterike) bashkëkohore të mësimdhënies. Ne i rivlerësojmë në mënyrë të vazhdueshme programet mësimore, me qëllim që të lehtësojmë procesin e të mësuarit për studentët.

Hapja e programeve të reja

- Departamenti Marketing-Turizëm parashikon të hapë "Shkollën e lartë profesionale" e cila në kurrikulën e saj do të ketë cikle studimi 2- vjeçare për:
 - Gastronomi,
 - Receptsi,
 - Shërbim bari (Kamarier, Banakier)
 - Forcë shitëse.

Këto programe studimi shihen si shumë të rëndësishme për përmirësimin e cilësisë së shërbimit. Ato do të synojnë të tërheqin atë pjesë të maturantëve që nuk do të ndjekin studimet universitare. Puna për hapjen e këtyre programeve do të përfshijë edhe vendosjen e marrëveshjeve me bizneset për të mundësuar realizimin e praktikave të mirëfillta pranë këtyre bizneseve.

- Do të organizohet dhe zhvillohet një studim tregu nga Departamenti Financë-Kontabilitet për mundësinë e hapjes së programit të ri të ciklit të parë të studimeve Bachelor në Ekonomiks.

2. Të garantojmë për studentët rritje profesionale dhe mundësi zhvillimi, nëpërmjet programeve të këshillimit profesional, praktikave profesionale (internships), prezantimeve dhe diskutimeve të drejtuara nga profesionistë të biznesit.

3. Të nxitim përfshirjen e studentëve në procesin e kërkimit shkencor që zhvillohet dhe drejtohet nga Fakulteti.

4. Të vlerësohet kohëzgjatja e studimeve (nga regjistrimi deri në diplomim) dhe të zhvillohen strategji për të zvogëluar periudhën e diplomimit. Kjo përfshin krijimin dhe implementimin e programeve të reja për studentët (të tilla si programe të avancimit profesional, të monitorimit dhe këshillimit) si dhe analizën e efekteve të tyre në kohëzgjatjen e studimeve.

Rezultatet e pritshme

Këto iniciativa do të japin një kontribut të rëndësishëm në përmirësimin e përvojës të mësimdhënies tek studentët dhe do të ofrojnë ndihmë të drejtpërdrejtë në realizimin e standardeve vizionare për periudhën 2017- 2020. Standardet kryesore në të cilat ne do përqëndrohemi janë: (1) përqindja e studentëve të përfshirë në kërkim; (2) afati maksimal gjashtë vjeçar i diplomimit; dhe (3) përqindja e kalueshmërisë nga viti i parë në vitin e dytë. Për vlerësimin e progresit lidhur me këto standarde të performancës, do të monitorojmë rezultatet e mëposhtme:

1. Duke qenë se nuk kemi një bazë krahasimi për numrin e studentëve të përfshirë në procesin e kërkimit (i përcaktuar si një proces që drejtohet nga një anëtar i kualifikuar i stafit të Fakultetit) qëllimi ynë është që për periudhën 2017-2020, të kemi një numër minimal prej 10 studentësh pjesëmarrës dhe kontribues në këto kërkimore. Përveç kësaj, ne kemi si objektiv që pas pjesëmarrjes së studentëve në disa aktivitete kërkimore, të paraqiten punimet dhe kontributi i tyre në një konferencë studentore.

2. Sipas statistikave të kaluara përqindja e studentëve që kalojnë nga viti i parë në vitin e dytë është rreth 52%. Synimi është që këtë përqindje ta çojmë në 70% në fund të periudhës katër vjeçare.

3. Mesatarja e studentëve që përfundojnë studimet brënda afatit gjashtë vjeçar të studimit është 63%. Qëllimi ynë është që të përmirësohet kjo mesatare në fund të periudhës katër vjeçare në 75%.

2. Programet Master

Programet e studimit të nivelit Master Profesional dhe Master i Shkencave ofrohen nga Departamentet e Fakultetit të Ekonomisë, kalojnë për diskutim në Dekanat dhe marrin miratimin përfundimtar nga Senati Akademik i Universitetit.

Qëllimi:

Synimet e Programeve Master përfshijnë: (1) tërheqjen e studentëve cilësorë nga Rajoni i Korçës dhe nga i gjithë vendi; (2) ofrimin e programeve Master që konkurojnë duke plotësuar apo tejkaluar programet më të mira të ofruara nga institucionet homologe; dhe (3) të sigurojmë një arsimim që rezulton në mundësi të mira punësimi për të diplomuarit tanë. Për të përmbushur këto synime ne vazhdimisht do kërkojmë të zhvillojmë dhe aplikojmë programe të cilësisë së lartë akademike duke mësuar nga eksperiencat më të mira të Fakulteteve, që janë të respektuar në fushat e tyre dhe shquhen për një interes të fortë në zhvillimin profesional të studentëve.

Prioritetet dhe iniciativat kryesore

1. Vazhdimi i punës për të siguruar që të katër programet Master Profesional dhe 2 programet Master i Shkencave të akreditoohen nga ASCAL.
2. Rritja e përpjekjeve për të rekrutuar dhe tërhequr studentë më të kualifikuar.
3. Në bashkëpunim me Zyrën e Marrëdhënieve me Jashtë të Universitetit, të mundësohen dhe të zhvillohen vizita ndërkombëtare studimore dhe shkëmbime për studentët e këtyre programeve.
4. Identifikimi i mundësive të tregut për programe të veçanta për të rritur staturën rajonale dhe kombëtare të Fakultetit.
5. Zhvillimi i një serie seminaresh me të diplomuarit e Fakultetit me synim përmirësimin e efektivitetit të mësimdhënies në nivelin universitar.
6. Në bashkëpunim me Zyrën e Karrierës dhe Shërbimeve Studentore të Universitetit, të shqyrtojmë mundësitë e zhvillimit të praktikave (internships) dhe mbështetjes me bursa për studentët e diplomuar.
7. Të rishqyrtojmë dhe të rekomandojmë ndryshimet e nevojshme në kërkesat (kriteret) për pranimet e studentëve në programet Master.
8. Mbështetje për zhvillimin e kurseve paraprake për plotësimin e njohurive të kërkuara për regjistrimin në programet Master.

Rezultatet e pritshme:

Iniciativat do të kontribuojnë në qëllimin tonë për të rekrutuar studentë të kualifikuar në të gjithë programet. Regjistrimi aktual vjetor në secilin program është:

Master Profesional Financë - Kontabilitet	61 studentë,
Master Profesional Administrim Biznesi	18 studentë,
Master Profesional Marketing	17 studentë,
Master Profesional Turizëm	11 studentë.

Objektivat tona janë :

1. Të gjithë programet Master të vazhdojnë të jenë të akredituara nga ASCAL.
2. Rritja e numrit të regjistrimeve me 10 studentë për çdo program Master deri në fund të periudhës katër vjeçare.
3. Të kryejmë të paktën një vizitë ndërkombëtare studimore vjetore në nivel fakulteti.
4. Zhvillimi dhe ofrimi i një programi të ri Master profesional në Administrim Publik nga Departamenti i Manaxhimit, pas rezultateve të dala nga studimi i tregut.
5. Zhvillimi dhe ofrimi i një programi të ri Master profesional "Guidë Turistike" nga Departamenti Marketing-Turizëm në bashkëpunim me Departamentin e Histori-Gjeografisë, Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë. Ky master do të propozohet nisur nga kërkesa e tregut të turizmit për këtë profesion. Masteri synon të përgatisë profesionistë guida, shoqërues, ose profesionistë të lirë pranë agjensive të udhëtimit.

6. Zhvillimi dhe ofrimi i një programi të përbashkët Master i Shkencave në Administrim Biznesi në Turizëm dhe Mikpritje (*Master of Sciences in Business Administration in Tourism and Hospitality*) nga Universiteti "Fan S. Noli", Fakulteti i Ekonomisë, Departamenti Marketing-Turizëm dhe Instituti Teknologjik i Edukimit i Maqedonisë Perëndimore, Fakulteti i Administrim Biznesit, Grevena, Greqi (*Technological Education Institution of Western Macedonia, Business Administration (Grevena), Mirsina, Grevena, Greece*). Një program me të njëjtin emërtim ofrohet tashmë nga departamenti Marketing-Turizëm, por këtu bëhet fjalë për një bashkëpunim me një partner evropian, që do sjellë eksperiencë të reja në turizëm dhe praktika të reja në mësimdhënie.

3. Kontributet intelektuale

Qëllimi:

Fakulteti i Ekonomisë njih dhe vlerëson mësimdhënien tradicionale dhe mësimdhënien dhe mësimnxënien nëpërmjet metodave aplikative. Këto aktivitete do të mbështetin dhe nxitin një proces mësimor sa më efektiv. Kontributet intelektuale që mbështetin njohjen kombëtare dhe ndërkombëtare të Fakultetit do të jenë veçanërisht të vlerësuara.

Prioritetet dhe iniciativat kryesore

1. Mbështetja e anëtarëve të fakultetit do të bëhet nëpërmjet veprimtarive të mëposhtme:

a. Ofrimi i forumeve të tilla si një seri seminaresh kërkimore dhe një seri leksionesh me të ftuar personalitete të shquar për diskutimin e çështjeve kërkimore. Kjo mund të përfshijë edhe të ftuar botues apo redaktorë nga disiplina të ndryshme për të diskutuar mbi strategjitë e publikimeve.

b. Zhvillimi dhe manaxhimi i një serie seminaresh për zhvillimin profesional lidhur me teknikat e fundit metodologjike dhe statistikore, si dhe promovimi dhe inkurajimi i granteve nga jashtë.

c. Inkurajimi i fakultetit për të marrë pjesë në takime profesionale dhe kërkimore në mënyrë që të qëndrohet në korrent të zhvillimeve të reja në fushat e interesit të anëtarëve të fakultetit.

d. Lehtësimin e aksesit në kompjutera, software, dhe burime të tjera.

e. Akordimi i një çmimi vjetor për arritjet më të spikatura në kërkim.

2. Fakulteti prezanton për çdo vit aktivitetin e anëtarëve të tij.

Rezultatet e pritshme

Iniciativat më lart do të kontribuojnë dhe do të jenë në përputhje edhe me Planin e Zhvillimit të Universitetit. Këto iniciativa do të ndihmojnë në rritjen e produktivitetit

kërkimor të fakultetit tonë. Qëllimi ynë është që të rrisim edhe numrin e publikimeve dhe prezantimeve akademike me 5 për qind në fund të kësaj periudhe 4-vjeçare.

4. Zhvillimi i Fakultetit dhe i Stafit

Zhvillimi i Fakultetit

Qëllimi:

Një fakultet ndryshe që punon për t'u përmirësuar vazhdimisht në fushat e kërkimit shkencor, mësimdhënies, dhe shërbimit është koncept thelbësor për avancimin e misionit të deklaruar të tij. Ndryshimet me shpejtësi të mjediseve të biznesit dhe të edukimit e bëjnë zhvillimin e vazhdueshëm të fakultetit një objektiv të rëndësishëm.

Prioritetet dhe iniciativat kryesore

1. Duke u bazuar në nevojat e identifikuar në vlerësimet vjetore, fakulteti do të marrë pjesë në konferenca, kurse afatshkurtra, praktika biznesi, ose aktivitete të tjera të nevojshme për përmirësimin e anëtarëve të tij në fushat mësimore, kërkimore, dhe të shërbimeve.
2. Departamentet do të mbështesin përpjekjet e Fakultetit për të siguruar shërbime në disiplinat përkatëse nëpërmjet pjesëmarrjes në organizata akademike dhe profesionale.
3. Inkurajimi i bashkëpunimit ndërdisiplinor (bashkëpunimi i Departamenteve) brenda fakultetit në zhvillimin e kurrikulës, mësimdhënies, dhe kërkimit shkencor.

Rezultatet e pritshme

Gjatë secilit prej viteve të këtij plani strategjik:

1. Të gjithë anëtarët e fakultetit do të dokumentojnë aktivitetet e tyre për zhvillimin profesional çdo vit dhe do të demonstrojnë përmirësim në aktivitetin e tyre kërkimor, në mësimdhënie, dhe në shërbime, të gjitha këto të identifikuar në vlerësimet e tyre vjetore.
2. I gjithë Fakulteti si një njësi nga pikëpamja e kualifikimit profesional do të vazhdojë të plotësojë kërkesat minimale ligjore për mbajtjen e këtij statusi.
3. Të gjithë drejtuesit e fakultetit do të përcaktojnë objektivat vjetore të performancës së synuar drejt zhvillimit profesional.

Zhvillimi i stafit

Qëllimi: Fakulteti do të përpiqet të krijojë një mjedis pune stimulues dhe pozitiv që promovon rritjen dhe zhvillimin profesional me mundësi të barabarta për anëtarët e stafit.

Prioritetet dhe iniciativat kryesore

1. Inkurajimi i zhvillimit profesional të stafit nëpërmjet pjesëmarrjes në aktivitete të ndryshme të tilla si programet e formimit profesional, seminarët, trajnimet, dhe aktivitetet e tjera brenda apo jashtë universitetit.
2. Krijimi i ekipeve të punës me pjesëmarrje nga departamente të ndryshme për të rritur komunikimin, projektet dhe proceset e përbashkëta.
3. Të akordohet një çmim vjetor për një anëtar të stafit për punën e papaguar gjatë vitit.

Rezultatet e pritshme

1. Çdo anëtar i stafit do të marrë pjesë në të paktën një prej veprimtarive të zhvillimit profesional në vit.
2. Çdo anëtar i stafit do të marrë pjesë në të paktën një ekip ndër-departmental në vit.

5. Ndërkombëtarizimi

Qëllimi:

Fakulteti do të përpiqet të ndjekë zhvillimet kombëtare dhe ndërkombëtare për të orientuar drejt tyre aktivitetet e kërkimit shkencor, mësimdhënies, dhe të shërbimit. Aktivitete të tilla do të inkurajohen, do të mbështeten edhe financiarisht me qëllim që të avancohet drejt mundësive ndërkombëtare arsimore për studentët, stafin dhe fakultetin, si dhe me aktivitetet e tjera të shërbimeve të lidhura edhe me misionin ndërkombëtar të Universitetit.

Prioritetet dhe iniciativat kryesore

1. Vazhdimisht do të punojmë drejt zgjerimit të dimensioneve ndërkombëtare të kurrikulës në të gjitha departamentet. Kjo përfshin:
 - a. Ofrimin e një shumëllojshmërie të kurseve me fokus ndërkombëtar.
 - b. Përfshirja e subjekteve me çështje dhe probleme aktuale ndërkombëtare në të gjithë kurrikulën në çdo departament.
2. Zhvillimi dhe lehtësimi i programeve të shkëmbimit me institucionet partnere jashtë vendit.
3. Krijimi dhe lehtësimi i mundësive për studentët e fakultetit për të studiuar jashtë vendit.
4. Krijimi i mundësive për Fakultetin për të siguruar fonde shtesë për të marrë pjesë në konferenca ndërkombëtare dhe workshope për zhvillimin e mëtejshëm të tij.
5. Inkurajimi dhe krijimi i mundësive financiare për të ftuar lektorë të njohur shqiptarë apo ndërkombëtarë për cikle leksionesh apo bashkëpunime të tjera me Fakultetin.

Rezultatet e pritshme

Këto iniciativa do të japin një kontribut të rëndësishëm për Vizionin Afatgjatë të Fakultetit duke rritur Ndërkombëtarizimin, i cili lidhet me qëllimet tematike të kërkimeve, me aktivitetet krijuese, me zhvillimin e fakultetit dhe të stafit si dhe me fitimin e një përvoje të rëndësishme arsimore. Këto iniciativa do të japin një ndihmë të madhe në arritjen e standardeve të cilësisë në planin afatgjatë.

1. Rritja e përqindjes së stafit të Fakultetit që do të përfshihet në kërkim shkencor ndërkombëtar, mësimdhënie, dhe aktivitete të tjera me 10 për qind gjatë katër viteve të ardhshme.
2. Rritja e numrit të studentëve që do të studiojnë të paktën një semestër jashtë vendit duke sjellë një përvojë ndërkombëtare studentore. Kjo do të bëhet e mundur përmes nxitjes dhe mbështetjes për të aplikuar dhe fituar në programe të përbashkëta shkëmbimi studentësh, ku Universiteti ynë është partner.

6. Diversiteti, gjithëpërfshirja dhe ndërgjegjësimi multikulturor.

Qëllimi:

Fakulteti i ekonomisë kërkon të përgatisë studentë që si profesionistë të ardhshëm të jenë të suksesshëm në një mjedis biznesi që ndryshon dhe zhvillohet shumë shpejt. Ne sigurojmë mundësi studimi dhe mbështetje për studentët që vijnë si përfaqësues të grupeve të ndryshme të komunitetit. Fakulteti është i përkushtuar në trajtimin e barabartë të të gjithë studentëve, pedagogëve dhe punonjësve të tjerë dhe në krijimin e një atmosfere mbështetëse dhe përfshirëse për të gjithë.

Prioritetet dhe iniciativat kryesore.

1. Rritja e numrit të studentëve të diplomuar nga grupet jo të përfaqësuara (kryesisht romë dhe ballkano egjiptianë) përmes programeve të mbështetjes dhe inkurajimi i zhvillimit akademik dhe i performancës së tyre.
2. Zhvillimi i kurrikulave të niveleve Bachelor dhe Master me qëllim që studentët të njohin çështjet e diversitetit kulturor dhe demografik, dhe sigurimi i mundësive të zhvillimit të kompetencave multikulturore.
3. Bashkëpunime me *Organizatat përfaqësuese* në nivel lokal dhe kombëtar për programe të lidhura me diversitetin me qëllim që të theksojmë suksesin e të gjithë studentëve, sidomos tek grupet jo të përfaqësuara.

7. Zhvillimi i bashkëpunimit (partneritetit) me biznesin.

Qëllimi:

Fakulteti beson se partneriteti me biznesin mund të sigurojë mundësi për:

- (1) studentët, në drejtim të zhvillimit të praktikave dhe gjetjes së vendeve të punës

- (2) departamentet, në drejtim të krijimit të mundësive për zhvillimin e programeve të duhura për praktikat profesionale, për lehtësimin e menaxhimit të programeve të studimit dhe për zhvillimin e platformave për kërkim dhe
- (3) fakultetin në formën e këshillimit strategjik dhe fondeve shtesë për programet akademike.

Prioritetet dhe iniciativat kryesore.

1. Mbajtja dhe forcimi i lidhjeve me komunitetin e biznesit përmes ish studentëve tanë (alumni) të punësuar nga biznesi. Kjo kërkon fillimisht krijimin e një sistemi database për një informacion të plotë të punësimit të të diplomuarve të Fakultetit.
2. Angazhimi për pjesëmarrjen e profesionistëve të bizneseve në rolin e këshilluesve (mentorëve) profesionalë për studentët.
3. Zhvillimi i një bashkëpunimi aktiv midis profesionistëve të biznesit dhe Fakultetit për të theksuar kërkimet e aplikuara dhe implikimet praktike të kërkimit akademik në shërbim të komunitetit të biznesit.
4. Ftesat e vazhdueshme për drejtuesit dhe specialistët e biznesit për leksione dhe diskutime.